

PROF. DR. AFRIM KRASNIQI

Instituti i Historisë / Akademia e Shkencave e Shqipërisë
afrimkrasniqi@gmail.com

**VRASJET NË KUFÏ NË VITIN 1990: MIDIS LIGJIT,
IDEOLOGJISË DHE DHUNËS SHTETËRORE****Abstrakt:**

Ky artikull analizon fenomenin e vrasjeve në kufi gjatë periudhës maj-dhjetor 1990, si një nga format më të dokumentuara të dhunës shtetërore në fundin e regjimit totalitar në Shqipëri. Edhe pse në aspektin sasior ato përbëjnë një pjesë të vogël të krimeve shtetërore gjatë viteve 1945-1990, këto ngjarje dëshmojnë vazhdimësinë e mekanizmave represivë të shtetit deri në prag të rrëzimit të tij. Nëpërmjet qasjes mikrohistorike, studimi synon të zbardhë kontradiktat midis legjislacionit dhe praktikës në vitin 1990, duke mbrojtur tezën se, në rastin e vrasjeve në kufi – të kryera në shkelje të ligjit – motivi ideologjik mbizotëroi mbi atë ligjor. Ky rast studimor rrëzon retorikën zyrtare të kohës për reforma demokratizuese. Krahasimi me praktikatat e vendeve të tjera ish-komuniste ndihmon të evidentohen veçoritë e modelit shqiptar, i cili shfaqet më brutal dhe më i vonuar në raport me proceset e liberalizimit në Europën Lindore. Analiza e qëndrimit të Partisë së Punës të Shqipërisë (PPSH), institucioneve, njësisve kufitare dhe komuniteteve lokale ndihmon të kuptohet se si frika, ideologjia dhe izolimi prodhuan një sistem shtypës ndaj të drejtave të njeriut, një shoqëri të bazuar në kodin e heshtjes dhe një post-tranzicion që dështoi të realizonte drejtësinë tranzitore.

Fjalë kyç:

Vrasjet në kufi, dhunë shtetërore, komunizëm, mikrohistori, PPSH, drejtësi tranzitore, Shqipëri 1990.

Hyrje

Pasditen e 11 dhjetorit 1990, Plenumi i 13-të i KQ të PPSH-së miratoi kërkesën kryesore të Lëvizjes Studentore për lejimin e pluralizmit, duke i dhënë fund sistemit njëpartiak në Shqipëri. Disa mijëra studentë dhe qytetarë u mblodhën në mbrëmje në qytetin “Studenti” për të festuar, ku u njoftua edhe krijimi i partisë së parë opozitare. Në të njëjtën orë, 265 km më larg, në zonën kufitare të fshatit Çiflik (Sarandë), njësi kufitar i repartit 103 ekzekutoi katër të rinj të moshës 18-25 vjeç gjatë tentativës së tyre për të kaluar kufirin drejt Greqisë.¹ Ata janë pjesë e listës me 58 qytetarë të identifikuar, të moshës 10-50 vjeç, të vrarë në kufi gjatë vitit 1990, nga të cilët 53 të vrarë në periudhën kur legjislacioni i kohës e ndalonte një praktikë të tillë. Ata nuk do të ishin të fundit. Më 20 dhjetor 1990, katër qytetarë, përfshirë një fëmijë, u ekzekutuan gjithashtu në Shkodër gjatë një tentative për arratisje,² dhe deri në fund të dhjetorit u vranë edhe disa të tjerë. Statistikisht, në fund të viteve ’80, Shqipëria ishte vendi ish-komunist jo vetëm me numrin më të lartë të vrasjeve në kufi, por gjatë vitit 1990 shënoi më shumë raste sesa të gjitha shtetet lindore të marra së bashku në vitet e fundit të regjimeve të tyre.

Rasti i vrasjeve në kufi i bashkon të gjitha elementet dhe ndihmon për të kuptuar jo vetëm konceptet dhe vijën politike të regjimit, por edhe gjendjen shoqërore, aspektin social dhe ekonomik, raportin e shtetit dhe të qytetarëve me ligjin dhe qasjen kulturore në raportet me fuqinë

¹ Komunikata ditore e Ministrisë së Punëve të Brendshme (MBP) nr. 292, e datës 13 dhjetor 1990, raportoi se “më datë 12.12.1990 gjashtë persona nga fshati Alikaj dhe një ushtar i repartit 991 tentuan të kalonin kufirin në postën kufitare Çiflik. Hapën zjarr dhe u plagos ushtari G. Zeneli. U vranë 3 shkelës, u kapën 2, kurse 2 u kthyen në thellësi. Kufomat iu kthyen familjeve.” Njoftimi përmban ndryshime thelbësore në krahasim me të dhënat e hetimit të mëvonshëm (ishin katër të vrarë, asnjë prej tyre nuk ishte i armatosur dhe se kufitari i plagosur, i cili vdiq më vonë, rezultoi i qëlluar aksidentalisht nga kolegët). Kastriot Dervishi, *Vrasjet në kufi në vitin 1990* (Tiranë: ISKK, 2015), 135.

² Më 20.12.1990 forcat e repartit nr. 299 të postës kufitare të Rrushkullit (Shkodër) ekzekutuan anëtarët e familjes Palma (Pal Palma, bashkëshorten e tij Zade Palma, vajzën 9-vjeçare Liljana Palma), si dhe të afërmin e tyre, Ernest Darragjati. *Fjalori Enciklopedik i Viktimave të Terrorit Komunist*, VI (Tiranë: ISKK, 2015), 183.

shtetërore. Këto ngjarje pasqyrojnë një shoqëri në krizë të thellë, nën një sistem dhune, ku kurba e vrasjeve rritej paralelisht me kurbën e atyre që tentonin largimin nga vendi, si edhe një mjedis politik në të cilin diskursi publik për demokratizim ishte në kontrast të thellë me to. Në atë sistem, koncepti i ligjit ishte kryesisht formal në kulturën shtetërore, publike dhe politike; për rrjedhojë, analiza e forcave të kufirit, rolit të komunitetit lokal dhe sjelljes së strukturave të larta shtetërore ndihmon për një trajtim më të thelluar të problematikës, në përputhje me tezën e Arendt-it se e keqja u institucionalizua në sistem, duke u dhënë vrasjeve në kufi mbështetje ideologjike dhe legjitimitet shtetëror. Trajtimi i këtyre vrasjeve edhe në aspektin e drejtësisë tranzitore ndihmon të evidentohen tiparet e përbashkëta dhe dallimet midis Shqipërisë dhe vendeve të tjera ish-komuniste, si dhe për të për të kuptuar më mirë rolin e madh që mbart e kaluara në vetëdijen tonë shtetërore dhe shoqërore.

Kontesti politik dhe ligjor

Viti 1990 shënoi zhvillime të rëndësishme politike, përfshirë krizën ekonomike, krizën e ambasadave, protesta dhe ngjarje dramatike, presione të jashtme, si dhe disa masa të rëndësishme politike nga brenda për të synuar hapjen e kontrolluar. Një muaj pas vrasjes së Çausheikut në Rumani, udhëheqja e PPSH-së vendosi se duhej të merreshin masa paraprake për të evituar situata të ngjashme, duke tentuar një ndryshim kozmetik të stilit dhe sistemit drejtues. Paketa e masave u prezantua më 22-23 janar në Plenumin e 9-të të Komitetit Qendror (KQ), ku temë dominuese ishin reflektimet mbi ndryshimet në Europën Lindore, pasi *“borgjezia ndërkombëtare synon që edhe në Shqipëri të kryhen ato procese kundërrevolucionare që ndodhën në Lindjen Evropiane”*. Plenumi miratoi dokumentin *“Mbi thellimin e masave për revolucionarizimin e jetës së partisë dhe të gjithë vendit”*, pjesë e të cilit ishin edhe ndryshimet në Kodin Penal *“në përputhje me nivelin e sotëm të zhvillimit të shoqërisë, siç janë nenet për veprimtarinë fetare, për agjitacionin dhe propagandën antishtetërore e antisocialiste, për internimin si masë penale, por veçanërisht si masë administrative etj.”*³

³ Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (më tej: AQSH), Fondi (më tej: F.), 14/Arkivi i Partisë (AP), Strukturë (Str.), Viti (më tej: V.) 1990, Dosja (më tej: D.) 1, fl.11. Komunikata, vendimi nr.5 dhe procesverbali i mbledhjes së Plenumit të 9-të të KQ të PPSH-së, 22-23 janar 1990.

Arratisja nuk ishin pjesë e cituar e vendimit, megjithëse u trajtua nga sekretari i KQ-së, Hekuran Isai. Grupet e punës shqyrtuan praktikat në vendet e tjera perëndimore dhe lindore, në të cilat kalimi i kufirit trajtohej vetëm me gjoba,⁴ dhe në prill hartuan draftet e para ligjore. Ndryshimet kaluan në Plenumin e 10-të dhe pas miratimit formal në Kuvendin Popullor hynë në fuqi më 14 maj 1990. Sipas paketës së ndryshimeve, pika 9, kalimi i paligjshëm i kufijve të shtetit nuk konsiderohej më tradhti ndaj atdheut me dënim me vdekje, por akt me dënim administrativ “*me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në pesë vjet*”.⁵ Zyrtarisht, që nga 14 maji 1990, çdo vrasje në kufi konsiderohej krim, dhe çdo person që vriste, qëllonte ose urdhëronte duhej të gjykohej si fajtor. Sipas praktikës shtetërore, çdo ligj apo ndryshim ligjor duhej të shoqërohej me akte nënligjore. Në rastin e vrasjeve në kufi, akti më i rëndësishëm nënligjor ishte shfuqizimi ose ndryshimi i dispozitave mbi përdorimin e armëve të zjarrit, në zbatim të rregullores nr. 01-40, datë 13.10.1989, “*Për shërbimin në njësitë piketë dhe anijet e postës kufitare*”. E ndryshuar disa herë, së fundi më 1985 dhe 1989, rregullorja i ngjante një traktati politik.⁶ Sipas rregullores lidhur me aktin e vrasjes në kufi, pasi njësitë bënte thirrjen “duart lart!” dhe shkelësi i kufirit nuk bindej, fillimisht bëhej qitje paralajmëruese (në ajër), dhe në rast se ai nuk ndalonte ose nuk kthehej, hapej zjarr.⁷

Kur në maj 1990 u kërkuan masa reformuese në legjislacion, si për dekriminalizimin e arratisjes, ashtu edhe për dekriminalizimin e agjitacionit dhe propagandës, si dhe për garantimin e lirisë së besimit dhe

⁴ *Po aty*, F. 14/AP-Str., V. 1990, D. 490, fl. 4. Relacion “Mbi disa ndryshime në Kodin Penal dhe në atë të Procedurës Penale”, nr.18, 08.01.1990.

⁵ *Fletorja Zyrtare*, nr.3, Ligji nr. 7380, datë 08.05.1990, “Për disa ndryshime në Kodin Penal të RPSSH”.

⁶ Në hyrje të saj theksohej: “Në themel të punës edukative, ushtarako-profesionale e teknike të Forcave të Kufirit qëndrojnë teoria marksiste-leniniste e Partisë sonë, mësimet e shokut Enver dhe të sekretarit të parë të KQ-së së PPSH-së, shokut Ramiz Alia, arti ushtarak i luftës popullore dhe ai i ruajtjes së kufirit” dhe se “hapja e zjarrit në kufi është një nga momentet më me përgjegjësi dhe merr kurdoherë karakter të mprehtë politik, sepse ka të bëjë me politikën e partisë dhe të shtetit”, *shih: AQSH*, F.14/AP-Str, V.1989, D.5-344. Rregullore e shërbimit të kufirit (miratuar me urdhrin e ministrit nr.01-40, datë 13.10.1989).

⁷ Jonila Godole, Valbona Bezati, “Në shërbim të popullit - politikat kufitare në Shqipërinë komuniste”, *Profile të “armikut të popullit” në diktaturë*, AIDSSH (Tiranë: Onufri, 2021), 15-27.

të organizimit, institucionet përgjegjëse – Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Drejtësisë (MD) – nuk ishin në gjendje dhe as nuk kishin qartësi mbi rolin e tyre në hartimin e akteve nënligjore pas ndryshimeve në Kodin Penal. Përveç sjelljes politike, Shqipëria kishte edhe mangësi në ekspertizë, sidomos në fushën e legjislacionit bashkëkohor. Ministria e Drejtësisë sapo ishte krijuar dhe juristët në dispozicion, sipas Ramiz Alisë, “*nuk kanë përvojë në fushën e legjislacionit*” ndaj “*duhet t’i ndihmojë ata në konceptimin e ligjeve*”.⁸ Koncepti se juristët nuk kishin përvojë dhe partia duhej t’i ndihmonte në hartimin e ligjeve mund të kuptohet vetëm në kontekstin e kohës, duke pasur parasysh natyrën e funksionimit të regjimit dhe faktin se drejtësia, në përgjithësi, ishte zbatuese formale e akteve politike.

Ministri Simon Stefani u mbrojti në qershor në Byronë Politike duke deklaruar se “*ne i kemi rishikuar të gjitha urdhrat, normat, që normojnë punën tonë*”.⁹ Në fakt, deri në fund të vitit 1990, asnjë nga aktet nënligjore respektive nuk kishte pësuar ndryshime. Kjo nuk ndodhi as kur Ramiz Alia mori telegrame e kërkesa të shumta nga *Amnesty International* dhe institucione ndërkombëtare, as kur drejt Presidiumit të Kuvendit Popullor dhe Komitetit Qendror mbërritën letra e sugjerime nga prokuroria, hetuesia, disa funksionarë lokalë të PPSH-së dhe institucione të tjera të varësisë politike. Më 8 qershor, në përgjigje të informacionit nr. 678/1990 të Degës së Punëve të Brendshme (DPB) Librazhd, ministri Stefani la shënimin:

“Komanda e kufirit, të gjithë kuadrot e sidomos sektori i edukimit të bëjnë përgatitje serioze dhe në bazë të problemeve që kanë dalë në reparte apo zona kufitare t’u shpjegohet ushtarëve, kuadrove, se masat e marra nga Partia e Qeveria nuk e liberalizojnë ligjin (rregulloren) për kufirin, por ato kërkojnë të forcohet, bile në këto momente duke e zbatuar pa lëshime”,¹⁰ pra një urdhër në kundërshtim me thelbin e ndryshimeve në Kodin Penal.

⁸ AQSH, F.14/AP-Organet Udhëheqëse (OU), V.1990, D.12, fl.70. Procesverbal i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të Partisë, 01.06.1990.

⁹ Po aty, F.14/AP-OU, V.1990, D.12, fl.48. Procesverbal i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të Partisë, 01.06.1990.

¹⁰ Gjykata e Tiranës, Vendim nr. 505, akti 507, datë 02.07.1994, cituar nga Çelo Hoxha, J. Godole dhe K. Dervishi, *Gjyqet ndaj nomenklaturës komuniste 1993-1996*, IDMC (Tiranë: Filara, 2023), 46.

Më 30 qershor 1990, komandanti i kufirit dha urdhër për ndalimin e hapjes së zjarrit në kufi, por disa ditë më pas ministri Stefani u telegrafoi rrethve kufitare anulimin e tij.¹¹ Situata mbeti e njëjtë edhe në dhjetor të vitit 1990, kur në Byronë Politike Alia pranoi:

“Këtë ligj ne e hoqëm, por ky ligj që u hoq nuk u zëvendësua me një ligj tjetër. Si duhet të luftohet kundër tendencës së arratisjes atëherë? Kush duhet të mendojë për këtë çështje?”¹²

Ky diskutim u mbështet nga anëtarë të tjerë të Byrosë, një prej të cilëve deklaroi: “*Ne nuk po funksionojmë si shtet juridik, nxjerrim urdhra pa pasur ligjin*”.¹³ Procesi i plotësimeve ligjore ishte aq i vonuar, sa ligji nr. 7449/1991, “*Për përdorimin e armëve të zjarrit nga forcat e ruajtjes së kufirit të ruajtjes së rendit publik dhe nga rojat ushtarake e civile të armatosura*”, hyri në fuqi vetëm pas ndryshimit të sistemit politik, në janar 1991. Në bazë të këtij ligji, rregullorja “*Për përdorimin e armëve të zjarrit nga forcat e ruajtjes së kufirit shtetëror*” u miratua më 2 maj 1991, pra një vit pas ndryshimeve në Kodin Penal.

Në aspektin politik nuk kishte vullnet për të ndaluar vrasjet, as për t’i parandaluar ato. Ky përfundim del nga një analizë e thelluar dhe e kryqëzuar e dokumentacionit arkivor të zyrtarëve më të lartë PPSH-së, të Byrosë Politike dhe të organeve shtetërore. Drejtuesit më të lartë, përfshirë Ramiz Alinë, nuk kanë asnjë rast të vetëm të distancimit apo të dënimit të vrasjeve në kufi, përkundrazi; ato janë toleruar dhe justifikuar. Më 12 prill, në Byronë Politike, Alia mbështeti ndryshimet, por paralajmëroi se, pavarësisht tyre, “*arratisja, duke qenë tradhti ndaj atdheut të mbetet si e tillë, ndryshe do të kishte konsekuenca politike jo të mira*”.¹⁴ Në gusht, gjatë mbledhjes së Sekretariatit të Komitetit Qendror, Alia i mori në mbrojtje rastet e vrasjeve, duke thënë:

“Vritet dikush në kufi pse tenton të arratiset dhe disa kërkojnë llogari e thonë: “Me ç’të drejtë qëllon kufitari e vret njerëz?” Ç’është ky mendim? Pse të mos qëllojë kufitari? Ku e di ai se

¹¹ *Po aty*.

¹² *AQSH*, F.14/AP-OU, V.1990, D.19, fl.285. Procesverbal i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të Partisë, 04.12.1990.

¹³ *Po aty*, fl.140. Procesverbal i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të Partisë, 04.12.1990.

¹⁴ *Po aty*, F.14/AP-OU, V. 1990, D.10, fl.48. Procesverbal i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të Partisë, 12.04.1990.

shkelësi i kufirit nuk është armik, apo kontrabandist? Gjithkush duhet të shpjegojë aspektin moral mbi këtë çështje”.¹⁵

Fakti që Ramiz Alia u përfshi edhe personalisht në trajtimin nga shteti të vrasjeve në kufi provohet edhe nga fondi i tij arkivor, i cili ruhet në AQSH. Për shembull, më 24 gusht 1990, Alia mori një njoftim nga Komiteti i Partisë (KP) i Rrethit të Kolonjës për vrasjet që ndodhën një natë më parë në zonën kufitare të Rehovës. Njoftimi i degës së MPB-së ishte i thatë dhe i mbushur me terminologji denigruese, duke akuzuar se personat e vrarë sulmuan kufitarët dhe iu rrëmbyen armët, dhe se në përpjekje e sipër për t’u mbrojtur dhe për të mos lëshuar armët, u vranë (jepen emrat e dy të vrarëve) etj. Mbi këtë njoftim bëri ndryshime fillimisht KP i Rrethit të Kolonjës dhe, më pas, mbi variantin e ndryshuar, ndërhyri vetë Alia me shkrimin e tij të dorës, duke e paraqitur ngjarjen si vetëmbrojtje të kufitarëve dhe duke premtuar se një komision i posaçëm po e hetonte rastin.¹⁶ Të dyja këto pohime rezultuan të pavërteta: nuk u zhvillua asnjë hetim, nuk u ngrit asnjë komision dhe, pas ndryshimeve politike, u konstatua se vrasja ishte një ekzekutim, jo akt vetëmbrojtjeje.

Nga publikimi i dosjeve për vrasjet në kufi gjatë viteve të fundit rezulton se në asnjë rast nuk ekzistojnë prova apo fakte që të mbështesin pretendimin se viktimat ishin të armatosur apo se kërcënonin sigurinë e kufitarëve, ndonëse varianti zyrtar i vitit 1990 i paraqiste këto ngjarje si akte vetëmbrojtjeje. Në këtë kontekst merr kuptim fakti se njoftimet për vrasjet në kufi, të ardhura nga KP-të e rretheve, hetuesia, degët e MPB-së, komandat ushtarake etj., nuk referonin asnjë ligj, rregullorë, urdhër apo nen përkatës. Kjo ndodhte jo vetëm sepse në sistemet totalitare kultura referuese ligjore ishte e panevojshme, por edhe sepse nuk ekzistonin dispozita të tilla ligjore arsyetuese.

Të dhëna mbi vrasjet dhe trajtimin e tyre

Gjatë Luftës së Ftohtë, Muri i Berlinit u bë simbol i ndarjes, rezistencës dhe vrasjeve, kryesisht për shkak të vendndodhjes, rëndësisë dhe kontekstit politik. Referuar *Berlin Wall Memorial*, midis viteve

¹⁵ *Po aty*, F.14/AP-OU, V.1990, D.48, fl.3. Procesverbal i mbledhjes së sekretarëve të KQ të Partisë, 24.08.1990.

¹⁶ *Po aty*, F. 489, V. 1990. D. 52, fl.1-3. Mbi një ngjarje në kufi, 29.06.1990.

1961-1989, të paktën 140 qytetarë humbën jetën në Murin e Berlinit në tentativë për arratisje (u vranë ose u rrëzuan gjatë kalimit, me pasojë vdekjen). Në të njëjtën kohë, rreth 251 qytetarë humbën jetën në periudhën para dhe gjatë ndërtimit të Murit, në tentativa për udhëtim ose arratisje drejt Republikës Federale Gjermane (RFGJ).¹⁷ Në Çekosllovakia, midis viteve 1948-1989, rreth 280 qytetarë humbën jetën për shkak të goditjes elektrike në vijën kufitare, mbytjes në ujë ose shpërthimit të minave, ose u vranë në kufi gjatë përpjekjes për t'u arratisur nga vendi; prej tyre, 42 i përkasin Sllovakisë së sotme.¹⁸ Në Bullgari, 339 qytetarë humbën jetën ose u vranë në përpjekje për t'u arratisur nga vendi gjatë periudhës 1946-1985.¹⁹ Vrasja e fundit e dokumentuar në kufi, në rastin bullgar, u regjistrua pak muaj përpara rënies së Murit të Berlinit, më 7 korrik 1989 (vrasja e një 19- vjeçari me kombësi gjermane).²⁰ Rumania, ashtu si Shqipëria, nuk ka ende të dhëna të sakta mbi statistikat e kufirit, por raportet flasin për mundësinë e qindra të vranëve nga rreth 50 mijë veta që u arratisën. Zyrtarisht, nga 99 ekzekutime të regjistruara midis viteve '60-'90, vetëm një person rezulton të ketë pasur sfond politik, edhe ai i akuzuar për vrasje.²¹

Ndryshe nga Shqipëria, e cila vazhdoi me një regjim të ashpër kontrolli dhe ndëshkimi ndaj qytetarëve²² që tentonin të largoheshin, vendet e tjera patën qasje më liberale. Gjatë viteve '70-'80, vendet e Europës Qendrore lejuan udhëtime të lira jashtë vendit për qytetarët, si

¹⁷ Hans-Hermann Hertle & Maria Nooke, Special CWIHP Research Report: "The Victims at the Berlin Wall, 1961-1989", *Wilson Center* (2001): 4-5.

¹⁸ "The communist regime established armed military units – Border Guard - to ensure a strict defence of the border", në:

https://mok.sk/en/kategorie_obeti/escapees-over-the-borders-iron-curtain/ (shikuar më 18.12.2025).

¹⁹ *Deutsche Welle* (2019), "The Bulgarian border was extremely dangerous", interviews with historian Christopher Nehring", në: <https://www.dw.com/en/the-bulgarian-border-was-extremely-dangerous/a-48290175> (shikuar më 18.12.2025).

²⁰ M. Sontheimer & B. Supp, "Avenging East Germans Killed in Bulgaria", (2008), në: <https://www.spiegel.de/international/europe/the-coldwar-s-forgotten-victims-avenging-east-germans-killed-in-bulgaria-a-563992.html> (shikuar më 18.12.2025).

²¹ Constantin-Raducu Stancu, *The Political Use of Capital Punishment in Communist Romania* (Vienna: Central European University, 2012), 52-53.

²² Afrim Krasniqi, "Sistemi qeverisës dhe aspekte të përfaqësimit politik në Shqipëri (1945 -1990)", në (ed.) Afrim Krasniqi, Vëra Stojarová, *State and society in the Communist Albania 1945-1990 / Shteti dhe shoqëria në Shqipërinë komuniste (1945 -1990)*, ISP (Tiranë: EMAL, 2020), 81.

dhe rastet e bashkimeve familjare. Rumania, gjithashtu, liberalizoi me ligj rastet e bashkimeve familjare, kurse Republika Demokratike Gjermane (RDGJ) e zgjeroi programin e saj të pagesës nga RFGJ-ja për lirim të burgosurve politikë, duke përfshirë mundësinë e "*bashkimit familjar*." Statistikisht, rreth 75% e emigrantëve që u arratisën nga Lindja drejt Perëndimit midis viteve 1950-1990 ishin pjesë e marrëveshjeve dhe akordeve ndërshtetërore, përfshirë edhe rastet e pakicave kombëtare dhe kulturore. Në rastin shqiptar, shkëmbimi u krye vetëm me palën jugosllave, ndryshe nga Gjermania, çka solli pasoja dramatike për individët që tentuan të arratiseshin drejt /ose nga Shqipëria. Në total, Shqipëria kishte përqindjen më të ulët të arratisjeve në Lindje, më pak se 0,5% e popullsisë, krahasuar me mbi 20% në Gjermaninë Lindore, 14% në Çekosllovakia, 6% në Poloni dhe 5,3% në Bullgari.²³

Referuar vrasjeve në kufi, studimi i kryer nga Instituti i Studimeve Politike (ISP, 2025) tregon se numri më i lartë i vrasjeve u shënuar në dhjetor 1990, me 12 raste, kur vendi ndodhej në kryqëzim midis dy sistemeve politike. Ky muaj u pasua nga qershori 1990 me 9 raste dhe maji 1990 me 8 raste, ndërsa gushti dhe nëntori shënuan nga 5 raste secili etj. Sa u përket zonave kufitare, rekordin për numrin e vrasjeve e mban zona e Shkodrës me 14 raste, e ndjekur nga Kolonja me 13 dhe Saranda me 8 raste. Në janar 1990 nuk ka raportime të dokumentuara për vrasje në kufi.

Statistika mbi vrasjet në kufi sipas muajve dhe zonave				
<i>Muaji 1990</i>	<i>Nr. i vrasjeve</i>	<i>Reparti kufitar</i>	<i>Rrethi</i>	<i>Nr. i vrasjeve</i>
Dhjetor	12	Reparti 299	Shkodër	14
Qershor	9	Reparti 310	Kolonjë	13
Maj	8	Reparti 103	Sarandë	8
Gusht dhe nëntor	5	Reparti 293	Dibër	4
Prill	4	Reparti 425	Korçë	4
Shkurt dhe shtator	3	Reparti 185	Gjirokastër	3
Korrik	2	Reparti 327	Pogradec	2
Tetor	1	Reparti 210	Librazhd	1
Janar dhe mars	0	Reparti 426 + 435	Korçë	1+1
<i>Përpunimi i të dhënave nga autori lidhet me rastet e dokumentuara të vrasjeve në kufi</i>				

²³ Luljeta Progni, Dokumentari "Kufij të përgjakur", historia e shqiptarëve përgjatë gjysmëshekullit të errët të diktaturës, *Kujto.al*, 15.03.2019. (Kujto.al. Publikuar në: <https://www.kultplus.com/filmi/dokumentari-kufij-te-pergjakur/>) (shikuar më 18.12.2025).

Në Arkivin e Shtetit ruhen një numër i madh letrash dhe telegramesh të aktivistëve të *Amnesty International* nga vende të ndryshme europiane, të cilët protestonin për vrasje konkrete dhe kërkonin nga Ramiz Alia ndryshimin e politikave shtetërore për respektimin e të drejtave të njeriut, si dhe lirim të individëve të ndryshëm të burgosur.²⁴ Raportet dhe mediet perëndimore flisnin për rreth 100 të vrarë. Në vitin 1995, prokuroria njoftoi hetime për 58 raste të provuara, ndërsa një raport jopublik i hetuesisë përmendte 83 raste,²⁵ ndërkohë që pas vitit 1992 qeveria dhe presidenti raportonin për një numër prej 600-1 000 qytetarësh të vrarë.²⁶ Përveç rastit të prokurorisë, të gjitha deklaratimet e tjera nuk shoqërohen me dokumente ose prova shteruese. Gjatë kërkimeve për këtë artikull rezultoi se disa dosje mungojnë në arkiva, komunikatat ditore të DPB-së janë të paplota dhe të parregullta, ndërsa njoftimet e Komiteteve të Partisë (KP) në rrethe ofrojnë të dhëna të ndryshme për të njëjtat ngjarje.

Në analizën rast pas rasti të dosjeve për të vrarët në kufi, e bazuar kryesisht në dëshmitë e personave të arrestuar gjatë tentativave për arratisje, të familjarëve, të atyre që ia dolën të arratiseshin, si edhe të personave të tjerë në dijeni të ngjarjeve, rezulton se motivet e arratisjes ishin të ndryshme. Sipas numrit të rasteve, faktorët kryesorë të arratisjes ishin dhuna politike dhe mungesa e lirive, vijimi i internimeve, burgosjet dhe diskriminimi politik, ndjekja politike nga Sigurimi, varfëria dhe kushtet e vështira ekonomike, mungesa e shpresës për ndryshim, pamundësia për të siguruar mallra bazë, izolimi nga pjesa tjetër e botës, si dhe dëshira për t'u bashkuar me familjarët jashtë vendit, për arsim jashtë ose për një jetë më të mirë. Shumica e të arratisurve vinin nga familje me "biografi të keqe", ndërsa midis rasteve gjendeshin edhe individë fatkeq, të cilët ndër vite tentuan pa sukses arratisjen.*

²⁴ *AQSH*, F.489, V.1990, D. 389, fl.5. Letra, telegrame etj., dërguar Kryetarit të Presidiumit të Kuvendit Popullor, Ramiz Alia, nga organizata "Amnistia Ndërkombëtare", shoqata "Shtetas të huaj" etj., për zbatimin e të drejtave të njeriut në vendin tonë etj.

²⁵ Qemal Lame, *Kur shembeshin themelet* (Tiranë: Onufri, 2014), 263.

²⁶ *Human Rights Watch* (HRW), "Human Rights in Post-Communist Albania, nr. 1606, 1 March 1996, në <https://www.refworld.org/reference/countryrep/hrw/1996/en/33471>; "Berisha Defends Genocide Law," *Illyria*, September 19, 1995.

* Një shembull tipik ishte ai i qytetarit B. Buzi, i cili tentoi dy herë arratisjen, më 1963 dhe më 1989. Në moshën 23-vjeçare, ai u arrestua nga forcat e kufirit dhe u dënua me

Në praktikën e vrasjeve në kufi haset edhe ajo që njihet si “dënim pas vrasjes”, një praktikë që konsistonte në refuzimin për t’u dorëzuar kufomat familjarëve për varrim. Ajo u aplikua disa herë përpara majit 1990, përfshirë dy vrasje të dokumentuara: vrasjen e dy personave në Sukaj (Shkodër)²⁷ dhe rastin Pashako në prill 1990.²⁸ Pas protestave në Shkodër, kjo praktikë u bë edhe më e shpeshtë. Raportet e nxjerra nga AQSH-ja dhe Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH) dëshmojnë të paktën shtatë raste të refuzimit për lejimin e varrimit nga familja: më 17 qershor për dy të vrarë në Korçë, më 21 qershor për dy të vrarë në Sarandë, më 24 qershor në zonën kufitare të Peshkopisë dhe, të njëjtën ditë, edhe në Kakavijë (Gjirokastrë), dhe më 17 korrik në Radat (Gjirokastrë) etj. Të vrarët “*nuk iu dorëzuan familjarëve*”;²⁹ varrimi i tyre u bë në vendin ku u vranë³⁰ ose pa njoftuar familjarët.³¹ Në një rast, autoritetet u treguan “zemërgjerë” dhe, më 22 gusht, një prej të vrarëve në kufi në Korçë u lejua të varrosej nga familja, me kusht që në varrim të merrnin pjesë vetëm familjarët dhe të mos organizoheshin homazhe apo vizita të tjera në familje. Raportohet se në këtë varrim morën pjesë vetëm shtatë persona: gjashtë anëtarë të familjes dhe oficeri i caktuar i Sigurimit.³² *Amnesty International* e ngriti këtë

15 vjet burg, pasuar nga tri dënime të tjera (1967, 1968, 1977). Pas daljes nga burgu, në tetor të vitit 1989, ai tentoi sërisht arratisjen, por më 16 shkurt 1990 u vra në kufi nga reparti 327 në Pogradec. Një shembull tjetër është edhe B. Shameti, i cili tentoi pa sukses arratisjen më 1966. Ai kaloi rreth një dekadë në burg politik dhe u vra në kufi gjatë tentativës tjetër në vitin 1988.

²⁷ Filip Guraziu, *Mollat e Vjetit të Ri. Dromca kujtimesh* (Tiranë: ISSK, 2021), (cituar nga <https://memorie.al/> (shikuar më 18.12.2025).

²⁸ AQSH, F.14/AP-OU, V.1990, D. 5, fl. 1. Relacion i Hetuesisë së Përgjithshme drejtuar Hekuran Isait, “Për dy persona nga Tirana që tentuan për t’u arratisur në Greqi nga territori i Sarandës”, 04.04.1990.

²⁹ *Po aty*, F.14/AP-OU, V.1990, D. 5, fl. 2. Relacion i Hetuesisë së Përgjithshme për ministrin S. Stefani “Për Harrallamb Papuçin dhe Ilia Dallen nga Saranda që u vranë duke kaluar kufirin për në Greqi”, 22.06.1990.

³⁰ *Po aty*, F.14/AP-OU, V.1990, D. 5, fl. 2. Relacion i Hetuesisë së Përgjithshme për ministrin S. Stefani, “Për Enver Dukën nga Tepelena që u vra duke kaluar kufirin në Peshkopi”, 27.06.1990.

³¹ AQSH, F.14/AP-OU, V.1990, D. 5, fl. 2. Relacion i Hetuesisë së Përgjithshme për ministrin H. Isai “Për Muharrem Velaj nga Fieri që u vra në kufi në Gjirokastrë”, 19.07.1990.

³² Progni, Dokumentari “Kufij të përgjakur”.

shqetësim,³³ por për shkak të kushteve në të cilat ndodhej Shqipëria, raporte të tilla nuk patën ndikim.

Problematikat me vrasjet në kufi lidheshin edhe me pasojat ligjore për individët tashmë të dënuar, përfshirë familjarët e internuar. Siç konstatohet me të drejtë, dekriminalizimi i arratisjes nuk solli dekriminalizimin *de facto* të internimit. Masa e ndëshkimit kolektiv familjar u hoq, por qytetarët e internuar nuk u rehabilituan dhe nuk iu lejua kthimi në banesat dhe pronat e tyre. Duke analizuar problematikën *Amnesty International* konkludoi se

“internimi vazhdoi të ekzistojë si një formë ndëshkimi plotësues që u aplikua nga gjykatat dhe mund të aplikohet ende deri në dy vjet si një ‘masë parandaluese’ për ata që nuk kishin kryer ndonjë krim, por aktivitetet e të cilëve ishin vlerësuar si ‘të papajftueshme me sjelljen e mirë dhe moralin shoqëror’”.³⁴

Megjithatë, reagimet publike nuk munguan. Më 19 maj, në sektorin e postës kufitare Pulaj (Shkodër), u vra Vat Beci nga fshati Bokë Velipojë. Në varrimin e tij, sipas DPB-së, morën pjesë rreth 150 persona.³⁵ Një korrespondencë tjetër dëshmon se gjatë varrimit të një të riu të vrarë në kufi, disa pjesëmarrës hodhën parulla kundër pushtetit popullor.³⁶ Sipas relacionit të DPB-së Shkodër, dërguar ministrit Stefani dhe sekretarit të KP-së të rrethit Xhemal Dymylja, gjatë ceremonisë më 16 qershor 1990 të të riut Pëllumbi, rreth 70 persona të moshës 17-26 vjeç shoqëruan trupin, duke mbajtur gjashtë kurora. Këta persona akuzoheshin se kishin hedhur disa parulla politike, si “*Poshtë komunizmi*”, “*Poshtë socializmi*”, “*Poshtë Ramiz Alia*”, “*Poshtë Partia*”, “*Poshtë Nexhmije Hoxha*”, “*Kjo parti është gjakpirëse*” etj. Një i ri citohet të ketë thënë: “*Shokë, të forcojmë unitetin tonë, se shikoni ç’po bën Ramiz Alia duke*

³³ AQSH, F.489, V.1990, D. 389, fl. 5. Letra, telegrame etj., dërguar Kryetarit të Presidiumit të Kuvendit Popullor, Ramiz Alia, nga organizata “Amnistia Ndërkombëtare”, shoqata “Shtetas të huaj” etj., për zbatimin e të drejtave të njeriut në vendin tonë etj.

³⁴ *Albania: Amnesty International Report* (London, UK: 1991), 28-31.

³⁵ AQSH, F.489, V.1990, D. 6, fl. 1. Informacion mbi disa shqetësime të ngritura lidhur me dorëzimin e kufomave të personave të vrarë në kufi, familjeve të tyre për varrim, 16.06.1990.

³⁶ *Po aty*, F.489, V.1990, D. 3, fl.7. Raport mbi gjendjen morale-politike të efektivit për 3-mujorin e dytë të vitit 1990.

vrarë njerëz përditë, poshtë partia, poshtë Ramiz Alia".³⁷ Në një tjetër rast, në gusht, varrimi i tre të rinjve të vrarë në kufi mori gjithashtu përmasa politike. Sipas relacionit të kryetarit të Hetuesisë së Përgjithshme, në ceremoninë e varrimit morën pjesë rreth 300 persona, të cilët gjatë ecjes ngritën dy gishtërinj lart, duke formuar germën "Y" dhe thirrën emrat e viktimave, të shoqëruara me parulla si "*Liri, Liri*" dhe "*Demokraci, Demokraci*".³⁸ Si në Shkodër, ashtu edhe në Korçë, protesta të tilla u shoqëruan me arrestimin e 14-16 personave, disa prej të cilëve u dënuan. Më 12 dhjetor, varrimi i të rinjve në Sarandë gjithashtu u shoqërua me protesta, aq sa organet policore thirrën në ndihmë strukturat vullnetare të aktivistëve politikë dhe punonjësit e mobilizuar të ndërmarrjeve, me arsyetimin se "*fshatarët e Alikos duan të shkatërrojnë qytetin*" dhe se "*pas tyre fshihet armiku i klasës dhe ai i jashtëm*".³⁹ Të dhëna të ngjashme mbi reagime dhe thirrje politike evidentohen edhe në raportet e DPB-së të 11 qershorit në Shkodër,⁴⁰ si dhe në *rastin e vrasjes në Kavajë në korrik 1990*⁴¹ etj. Megjithëse me elemente dalluese dhe situata të ndryshme, asnjë nga këto protesta nuk arriti nivelin e protestave të ngjashme që u zhvilluan në vendet ish-komuniste, si Gjermania Lindore, Polonia, Çekosllovakia, Hungaria etj., si reagim ndaj vrasjeve në kufi ose të vrasjeve me karakter politik. Shqipëria vinte nga një përvojë specifike dhe sensi i reagimit publik ishte ende i paformuar. Nga ana tjetër, regjimi vijoi të ndiqte një linjë të ashpër politike ndaj çdo proteste, reagimi, kritike apo ngjarjeve antiqeveritare.

Vlen të theksohet se kjo temë u përfshi pjesërisht në korrespondencën midis shkrimtarit më të njohur Ismail Kadare dhe udhëheqësit të shtetit, Ramiz Alia.⁴² Përgjigjja e Alisë më 21 maj e

³⁷ *Po aty*, F. 373/AP, V. 1990, D. 6, fl.2-3. Informacion mbi disa shqetësime të ngritura lidhur me dorëzimin e kufomave të personave të vrarë në kufi, familjeve të tyre për varrim, 16.06.1990.

³⁸ *Po aty*, F.489, V.1990, D.6, fl.4. Relacion i prokurorit të Përgjithshëm, Rr. Mino, "Për ngjarjen e datës 24.8.1990 në qytetin e Korçës", 02.09.1990.

³⁹ AMPB, Komunikata ditore e MPB-së nr. 292, 13 dhjetor 1990.

⁴⁰ AQSH, F.489, V.1990, D. 6, fl.1-2. Informacion mbi disa shqetësime të ngritura lidhur me dorëzimin e kufomave të personave të vrarë në kufi, familjeve të tyre për varrim, 16.06.1990.

⁴¹ *Po aty*, F.489, V.1990, D.6, fl. 2. Më 10 korrik 1990 u vra nga forcat speciale policore 22-vjeçari, Josif Budo.

⁴² Në letrën e 3 majit 1990, Kadare i shkruan: "Nuk e kuptoj ç't mirë ka vendi ynë nga vrasjet e papërligjura që ndodhin në kufi dhe siç qe rasti i fundit i një çifti në Shkodër,

injoroi këtë adresim, por më 5 korrik ai mori një letër tjetër nga Kinostudioja, ku shprehej i njëjti shqetësim.⁴³ Debatu u rikthye gjatë takimit me intelektualët në gusht 1990.⁴⁴ Alia u shpreh se kishte dhënë urdhër kategorik për të mos përdorur armët, por nga salla iu kundërpërgjigjën: “*Janë thyer këto urdhra*”. Ai deklaroi gjithashtu se po përgatitej një ligj i ri, i cili do të parashikonte masa në rast të tejkalimit të kompetencave. Pavarësisht se qëllimi kryesor i adresimit të kësaj çështjeje lidhej më tepër me kritikën ndaj Sigurimit dhe mungesën e informacionit publik sesa me mbrojtjen e viktimave të pafajshme apo kërkimin e drejtësisë, ato janë rastet e para kur vrasjet në kufi u trajtuan në forume më të gjera sesa strukturat e PPSH-së. Megjithatë, duhet theksuar se nga rreth 20 intelektualë që arritën të jepnin intervista, përfshirë edhe në radion “Zëri i Amerikës”, gjatë vitit 1990, asnjëri nuk e adresoi publikisht këtë shqetësim. Media zyrtare brenda vendit, natyrisht, nuk e trajtoi këtë çështje.

Në vijim të kulturës denigruese të konceptit të “armikut”, etiketimi zyrtar – “*vagabondë*”, “*rrugaçë*”, “*të deklasuara*”, “*armiq*”, “*pa moral dhe personalitet*”, “*parazitë*”, “*të pamartuar, të ndikuar nga televizioni*”⁴⁵ etj., u përdor në të gjitha njoftimet për vrasjet në kufi. Kjo praktikë ushqente konceptin e njeriut negativ, përfaqësuar nga “*familjet e këqija*”, përballë të cilit qëndron njeriu i mirë nga “*familjet e mira*”, besnik ndaj shtetit dhe partisë. Në një raportim në Byronë Politike, drejtuesi i Komitetit të Partisë të Rrethit të Gjirokastrës, Binaj, theksonte se midis tyre kishte edhe persona nga familje të konsideruara “*të mira*”,

i cili, duke qenë i rrethuar, u masakrua pa kurrfarë arsyeje? Kjo vrasje e ndodhur pikërisht në kohën që po shqyrtohet ligji i ri për udhëtimet jashtë, ka tronditur opinionin shqiptar dhe kërkimi e dënimi i fajtorëve do të ishte më i logjikshëm, sesa kënaqësia e shprehur andej-këndej prej ithtarëve të dhunës me fjalët cinike “ç’ua bëjmë mirë?”. Qytetarët e një vendi sovran nuk mund të merren nëpër këmbë, të arrestohen pa të drejtë, të fyhen e rrihen e aq më pak të vriten si qen⁴².” Ismail Kadare. *Nga njëri dhjetor në tjetrin* (Paris: Fayard, 1991), 128-129.

⁴³ Teodor Laço, *Kohë për të kujtuar, kohë për të harruar* (Tiranë: Toena, 1998), 25-27. Letra ishte sintezë e debatit të sekretarit të Komitetit Qendror, Foto Çami, me stafin e Kinostudios. Gjatë këtij takimi, K. Dhamo pyeti: “Po vrasjet në kufi? Janë jo një e dy, por disa, siç ka dëgjuar para pak kohe edhe në Leskovik”, dhe duke mos pranuar alibinë se mund të ishin keqbërës, ai vijoi: “Po dëgjojmë se janë djem 17 vjeçarë që vriten pa paralajmërim”.

⁴⁴ *AQSH*, F.489, V.1990, D. 441, fl. 29. Takimi me intelektualët, 10.08.1990.

⁴⁵ *Po aty*, F.14/AP-OU, V.1990, D.1, fl.130. Komunikata, vendimi nr. 5 dhe procesverbali i mbledhjes së Plenumit të 9-të të KQ të PPSH-së, 22-23 janar 1990.

madje edhe fëmijë komunistësh.⁴⁶ Kjo praktikë denigruese nuk u drejtohej vetëm individëve, por edhe komuniteteve dhe kolektivitet. Kështu, për shembull, kryetari i DPB-së në Shkodër, në relacionin e tij drejtuar strukturave të KQ-së, i etiketonte si “*vagabondë, hajdutë, pa punë, kontingjente të ndjekjes së krimeve*”⁴⁷ jo vetëm 17-vjeçarin e vrarë më 16 qershor dhe shokun e tij të plagosur, por edhe pjesëmarrësit në protestën gjatë varrimit. Në rastin e Korçës thuhej madje se në varrim morën pjesë rreth 300 persona, “*të dënuar e me personalitet të keq*”.⁴⁸ Njoftimi u bë në të njëjtën ditë me varrimin dhe, teorikisht, as strukturat policore dhe as ato partiake nuk kishin mundësi të verifikonin të dhënat penale apo politike të të gjithë pjesëmarrësve për të arritur në përfundimin se ata ishin të tillë. Ndër pjesëmarrësit kishte edhe familjarë të viktimave, të moshuar, gra dhe fëmijë, si dhe banorë të zonës, pra një komunitet normal lokal. E njëjta praktikë u evidentua edhe gjatë krizës së ambasadave.

Teza se ata ishin të rinj të papunë, “parazitë” në Shqipëri, bie poshtë nga vetë të dhënat zyrtare. Brenda strukturave të Byrosë dhe Sekretariatit të KQ-së pranohej se shumica absolute e tyre ishin kryesisht të rinj 18-20 vjeç, të prirë për të provuar “*parajsën borgjeze*”,⁴⁹ pa qëllime armiqësore dhe me dëshirën për kushte më të mira jetese. Shumë prej tyre, në fakt, ishin të angazhuar në punë.⁵⁰ Midis të dënuarve 14-17 vjeç u raportua se ishte edhe një i ri i akuzuar për tradhti ndaj atdheut, një akuzë e habitshme për një moshë kaq të re; verifikimet treguan se dënimi lidhej me kapjen gjatë tentativës për arratisje. Midis të rinjve 18-26 vjeç ishin gjithashtu 10 persona të akuzuar për tradhti ndaj atdheut dhe 20 të tjerë për kalim të paligjshëm të kufirit.⁵¹ Në aspektin shoqëror, 57% ishin punëtorë, 23% kooperativistë, 1,1% nxënës dhe studentë, 9,2% ushtarakë,

⁴⁶ *Po aty*, F.14/AP-OU, V.1990, D.19, fl.101. Procesverbal i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të Partisë, 04.12.1990.

⁴⁷ *Po aty*, F.489, V.1990, D. 6. Informacion i kryetarit të DPB-së Shkodër, Çapajev Taçi, drejtuar MPB-së dhe Komitetit të Partisë të Rrethit të Shkodrës, 16.06.1990. Cituar sipas: Kastriot Dervishi, *Vrasjet në kufi në vitin 1990* (Tiranë: ISKK, 2015), 65.

⁴⁸ *Po aty*, F.489, V.1990. D.6, fl.2-3. Relacion “Për ngjarjen e datës 24.8.1990 në qytetin e Korçës”, 02.09.1990.

⁴⁹ *Po aty*, F.14/AP-OU, V.1990, D.19, fl.55. Procesverbal i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të Partisë, 04.12.1990.

⁵⁰ *Po aty*.

⁵¹ *Po aty*, F.489, V. 1990, D. 276, fl. 12. “Për të dhënat e statistikës gjyqësore”.

2,7% nëpunës dhe vetëm 6,8% të papunë.⁵² Në total, mbi 1 200 persona tentuan arratisjen drejt Greqisë, 910 drejt Jugosllavisë dhe 52 drejt Italisë. Relacioni theksonte se tentativat më të shumta u shënuan në katër rrethe: Sarandë (407), Gjirokastrë (360), Korçë (323) dhe Shkodër (440).*

Kufiri dhe kufitarët, aspektet e përgjegjësive

Sipas legjislacionit në fuqi, përgjegjësia për ruajtjen e kufirit i takonte Drejtorisë Kufitare në MPB (pas vitit 1989, Komanda e Forcave të Kufirit). Në ndihmë të forcave kufitare llogariteshin edhe forcat vullnetare të vetëmbrojtjes, nënrepartet dhe repartet ushtarake të Ministrisë së Mbrojtjes Popullore (MMP). Forcat e kufirit përbënin një prej elementeve kryesore të identitetit të regjimeve të mbyllura. Ndonëse kjo mund të duket paradoksale, Shqipëria ishte nga vendet e pakta ku shqetësim nuk përbënin tentativat nga jashtë (ardhja e emigrantëve), por arratisjet nga brenda vendit. Për këtë arsye, vigjilenca, kontrolli i kufirit dhe masat e sigurisë kishin si qëllim parandalimin, madje deri në eliminimin e rasteve të arratisjeve. Në këtë kontekst, përzgjedhja e ushtarakëve dhe efektivave mbështetës në kufi ishte çështje prioritare dhe, mbi të gjitha, një çështje me natyrë politike. Një botim i Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit (ISKK) zbërthen në detaje mekanizmin e përzgjedhjes së ushtarëve të kufirit, duke nisur nga puna operative selektive në lagje e fshatra,⁵³ biografia e tyre dhe deri te stërvitja e posaçme. Në përgjithësi, ata shfaqnin militantizëm ndaj “*armiqve të brendshëm e të jashtëm*” dhe bindje të verbër ndaj urdhrave, veçanërisht në rastet e vrasjeve në kufi. Në një prej fjalimeve të tij, Alia theksoi se:

⁵² *Po aty*, fl. 13. “Për të dhënat e statistikës gjyqësore”.

* Vetëm në një ditë, më 17 dhjetor, në Shkodër kaluan kufirin përmes lumit Buna 28 persona, si dhe më 19-20 dhjetor në zonën e postës Rrushkull kaluan kufirin në mënyrë të paligjshme 21 persona, ndërsa 15 të tjerë u arrestuan. Dy rastet e fundit krijuan shqetësim edhe për Jugosllavinë, e cila kërkoi mbledhje urgjente të komisionit të përbashkët ndërkufitar për shqyrtimin e tyre. Edhe në Sarandë, midis datave 20-27 dhjetor 1990, tentuan të kalonin kufirin 80 persona, kryesisht nga zonat minoritare. Në një ditë të vetme në Leshnicë tentuan kalimin 44 persona, të cilët u arrestuan, por më pas u liruan nga organet e rendit. I vetmi rreth nga i cili nuk ishte raportuar ende asnjë tentativë arratisjeje ishte Gramshi, zonë e izoluar midis Elbasanit dhe Beratit.

⁵³ Kastriot Dervishi, *Kufiri shqiptar dhe ferri komunist* (Tiranë: ISKK, 2015), 7.

“Kur flasim për figurën e komunistit, oficerit e punëtorit operativ, apo të kufitarit, rëndësi të veçantë ka që këta të jenë të formuar politikisht dhe ideologjikisht dhe të pastër moralisht. Këtij aspekti, Partia duhet t'i kushtojë vëmendjen e dorës së parë.”⁵⁴

Në vitin 1990, numri i komunistëve në njësitë kufitare ishte rritur ndjeshëm. Vetëm në zonën kufitare të Gjirokastrës kishte tre byro dhe 44 organizata-bazë partie me gjithsej 487 komunistë,⁵⁵ ose 84% më shumë sesa numri i tyre në nivel kombëtar në zonat kufitare në vitin 1987.

Në figurën e “kufitarit” u investua për një kohë të gjatë miti i mbrojtësit të atdheut, heroit që mbron vendin nga diversantët dhe tradhtarët. Çdo i rënë në detyrë shpallej dëshmor; emrat e tyre vendoseshin në rrugë, shkolla dhe objekte publike. Festalet përfshinin këngë kushtuar trimërisë së tyre, ndërsa revistat periodike të MPB-së apo MMP-së botonin vazhdimisht histori të shumta mbi sukseset dhe arritjet heroike të kufitarëve. Emërimi i detyruar në zonat kufitare, larg familjes dhe vendlindjes, rregullat strikte dhe presioni nga hierarkia, kushtet e vështira të shërbimit, si dhe një sistem intensiv propagandues – i vetmi burim informimi për ta – i bënë kufitarët ndër trupat më të indoktrinuara dhe më besnike të regjimit. Nga verifikimet dokumentare rezulton se nuk gjendet asnjë raport që të konfirmojë ndonjë rast ku kufitarët të kenë refuzuar të qëllonin në kufi, pavarësisht se ata ishin në dijeni se pas majit 1990 kjo praktikë ndalohej me ligj.

Gjatë muajve qershor-shtator 1990, Alia organizoi disa mbledhje dhe takime me ushtarakët, përfshirë forcat kufitare, në përgjigje të një raporti që ngrinte alarmin për dy fenomene. I pari ishte se ushtarët në kufi kishin mungesë informacioni mbi zhvillimet brenda e jashtë vendit,⁵⁶ shfaqnin “*tendenca pacifiste*” dhe “*mungesë të ndjesisë së alarmit*”, si dhe kishin shprehur paqartësi e pakënaqësi ndaj vendimeve të KQ-së, përfshirë ndryshimin e kursit politik në raport me SHBA-në dhe BS-në,⁵⁷ apo se një oficer kishte shprehur simpati për elementët puçistë. Fenomeni

⁵⁴ AQSH, F.14/AP-OU, V.1988, D.20, fl.22. Procesverbal i mbledhjes së Sekretariatit të KQ të Partisë, 01.06.1988.

⁵⁵ Po aty, F.14/AP-OU, V.1987, D. 24, fl. 6. Raport “Mbi punën e partisë për forcimin e gjendjes moralo-politike në zonën kufitare”.

⁵⁶ Po aty, F.724, V.1990, D.15, fl.3. “Probleme dhe detyra që dalin për të përballuar disa shqetësime në kufi dhe ushtri”.

⁵⁷ Po aty, F.489, V.1990, D.3, fl. 6. “Raport mbi gjendjen morale-politike të efektivit për 3-mujorin e dytë 1990”.

i dytë lidhej me rritjen e ndjeshme të rasteve të dezertimeve në radhët e ushtarakëve. Ushtria, e cila konsiderohej si fortesë dhe besnike e regjimit, po dezertonte, duke pasur statistikisht përqindjen më të lartë në raport me vendet e Lindjes gjatë viteve 1985-1989. Dokumentet zyrtare ofrojnë të dhëna ilustruese. Më 30 dhjetor 1990, një raport për Byronë Politike⁵⁸ pranoi se kohët e fundit ishin arratisur 87 ushtarë dhe 6 nënoficerë: 63 drejt Greqisë, 23 drejt Jugosllavisë dhe 1 drejt Italisë.⁵⁹ Një tjetër raport periferik konfirmonte se 7 nënoficerë dhe 12 ushtarë ishin arrestuar për tentativë arratisje,⁶⁰ ndërsa një raport tjetër informonte për 32 raste arratisjeje që nga janari 1990, duke theksuar se 80% e arratisjeve ishin realizuar nga të rinj të forcave të kufirit, kryesisht pas kthimit të ushtarëve nga lejet pranë familjeve të tyre.⁶¹ Në korrik, ministri Kiço Mustaqi raportoi se 24 ushtarë kishin hyrë në ambasada, ndërsa 20 të tjerë kishin ikur përmes kufirit – informacion veçanërisht shqetësues, pasi të gjithë ishin “*me përbërje të mirë politike*”.⁶² Vetëm në repartin nr. 4031 në Pogradec gjatë 120 ditëve u arratisën 14 ushtarë dhe 3 oficerë,⁶³ të gjithë me përbërje të mirë politike.⁶⁴ Më 1 nëntor, Komiteti i Partisë i Rrethit të Gjirokastrës njoftoi për arratisjen e 4 ushtarëve të tjerë, efektivë të postës kufitare Martinë. Sipas informacionit, midis tyre ishte edhe një ushtar 20 vjeç, sekretar i organizatës së rinisë së Postës.⁶⁵

Pjesë e krizës në ushtri ishte edhe rritja e rasteve të vetëvrasjeve ose incidenteve me vrasje midis ushtarakëve. Në dokumentacionin arkivor gjenden relacione të shumta për vrasje ose vetëvrasje në reparte

⁵⁸ *Po aty*, F.14/AP-Str., V.1990, D.2/1, fl. 10. Informacion i MPB-së nr.1009: “Disa tentime masive për kalimin e kufirit në rrethet Shkodër, Sarandë e Gjirokastrë dhe shqetësimet dhe në efektivat e kufirit”, 30.12.1990.

⁵⁹ *Po aty*.

⁶⁰ *Po aty*, F.489, V.1990, D.3, fl. 6. “Raport mbi gjendjen morale-politike të efektivit për 3-mujorin e dytë 1990”.

⁶¹ *Po aty*, F.724, V.1990, D.15, fl.3. “Probleme dhe detyra që dalin për të përballuar disa shqetësime në kufi dhe ushtri”.

⁶² *Po aty*, F.14/AP-Str., V.1990, D.3, fl.226. Raport, informacion, vendim nr. 63, si dhe procesverbal i mbledhjes së Plenumit të KQ-së, datë 6-7 korrik 1990.

⁶³ *AQSH*, F.489, V.1990, D.7, fl.1. Informacion mbi disa shqetësime dhe masat që u morën për të parandaluar rastet e arratisjeve dhe thellimin e disiplinës në ushtri, 16.10.1990.

⁶⁴ *Po aty*, F. 14/AP-Str., V.1990, D.4, fl. 167. Mbledhje e Byrosë Politike, 6-7 nëntor 1990.

⁶⁵ *Po aty*, F.14/AP-Str., V.1990, D.3, fl.2. Informacion “Mbi realizimin e kalimit të paligjshëm të kufirit nga katër ushtarë të postës kufitare të Marinës”, 01.11.1990.

ushtarake, si më 20 mars, 7 maj, 19 korrik dhe 24 tetor në Shijak; më 28 mars në Berat; më 13 prill në Shëngjin; më 5 dhe 8 qershor në Fier; më 24 korrik dhe 24 tetor në Durrës; më 2 tetor në Ersekë etj. Shumica e rasteve raportohen si incidente gjatë përdorimit të armëve, por në një prej rasteve në Ersekë u konstatua më vonë se ushtari ishte vetëvrasës.⁶⁶ Po ashtu, më 9 gusht një ushtar i repartit nr. 8975 në Zhepë (Skrapar) vrau një ushtarak të lartë dhe dy oficerë rezervistë, si dhe plagosi një tjetër ushtarak të lartë dhe një ushtar.⁶⁷ Vrasje të tjera midis ushtarëve, eprorëve dhe vartësve u raportuan edhe në zonat kufitare të Sarandës dhe Tropojës, ndërsa më 5 tetor u regjistrua një shkëmbim zjarri midis njësisë kufitare dhe një grupi ushtarësh që tentuan arratisjen.⁶⁸

Imazhi i kufitarëve u bë aq negativ në disa zona, sa sipas raportit disa prej tyre nuk kishin dëshirë të shfaqeshin si kufitarë jashtë reparteve dhe postave të tyre, madje arrinin deri atje sa ndërronin edhe këpucët gjatë periudhës së lejes që të mos identifikoheshin në publik si të tillë.⁶⁹ Në një rast, më 5 qershor 1990, një kufitar u vetëplagos qëllimisht në vendrojtë, pasi hetimet treguan se nuk i përballonte dot vështirësitë e shërbimit ushtarak.⁷⁰ Një tjetër raport i Bashkimit të Rinisë (BR) evidentoi mungesë vullneti dhe gatishmërie midis ushtarëve të rinj, si dhe tendenca për t'iu shmangur shërbimit në vijën e parë kufitare.⁷¹ Në rreth 170 raste, kufitarët kishin bërë përpjekje deri në braktisje të shërbimit, për t'u larguar nga vija e parë dhe për të shmangur "*detyrat dhe postat e vështira*", ku kryesisht ndodhnin vrasjet. Në një prej raporteve thuhej se ushtarët nxiteshin për arratisje, duke i etiketuar "*si njerëz të humbur, që nuk shfrytëzojnë rastin për të ikur jashtë*", apo se "*do t'u mallkojnë nënat*

⁶⁶ *Po aty*, F.489, V.1990. D.2/1, fl.2. Njoftim për ngjarjen e jashtëzakonshme në Br3K Ersekë, 05.10.1990.

⁶⁷ *Po aty*, F.489, V.1990. D.2/1, fl.2. Njoftim për ngjarjen e jashtëzakonshme të ndodhur në repartin ushtarak nr. 8975, Zhepë të B.V.S. Skrapar, 11.09.1990.

⁶⁸ *Po aty*, F. 489, V.1990, D.279, fl.10. Për ushtar L.Vorfin dhe katër persona të tjerë që kaluan kufirin në Korçë, 06.10.1990.

⁶⁹ *Po aty*, F.724, V.1990, D.15, fl.3. "Probleme dhe detyra që dalin për të përballuar disa shqetësime në kufi dhe ushtri".

⁷⁰ *Po aty*, F.489, V.1990, D.2, fl.1. Njoftim mbi ngjarjen e jashtëzakonshme në R.6561, 08.06.1990.

⁷¹ *Po aty*, F.724, V.1990, D.79, fl.2. Raport i Komitetit Qendror të Bashkimit të Rinisë së Punës të Shqipërisë për rolin aktiv të rinisë në ushtri.

po ta dinë se ju kapni e vrisni njerëz në kufi.”⁷² Gjatë konsultave, familjarët e kufitarëve konfirmuan se presioni nga banorët e zonës ishte shtuar, duke krijuar një distancim midis tyre dhe ushtrisë.⁷³ Pakënaqësi u shfaqën edhe për shkak të bllokimit nga ushtria të kullotave apo tokave për mbjellje afër kufirit⁷⁴ etj. Prindërit kërkuan që fëmijët e tyre, të cilët shërbenin si ushtarë, të mos ekspozoheshin gjatë fazës hetimore dhe gjyqësore të vrasjeve ose arrestimeve në kufi, pasi kjo mund të krijonte konflikte. Gjithashtu, ata sugjeruan që partia t’u dërgonte letra vlerësuese familjeve të tyre, qendrave të punës së prindërve dhe organizatave të rinisë ku ata kishin milituar para shërbimit ushtarak.⁷⁵ Paralelisht u organizuan seminare me përmbajtje politike për efektivat kufitare dhe familjarët e tyre, të zhvilluara në përputhje me vijën ideologjike të partisë, ushtrisë dhe Sigurimit të Shtetit.⁷⁶

Akt zyrtar vlerësimi ishte gjithashtu akordimi i një numri të lartë medaljesh dhe dekoratash, të cilat kishin një funksion të rëndësishëm politik dhe social, duke përfshirë angazhimin në punë dhe karrierën për të ardhmen. Medaljet më të larta u dhanë për vrasjet në kufi, si për individë ashtu edhe për kolektiva; p.sh., të gjithë kolektivit të postës kufitare Rrushkull në Shkodër, që rezultonte me numrin më të lartë të vrasjeve.⁷⁷ Sipas raportimeve nga Presidiumi i KP-së, *gjatë periudhës janar 1989 – mars 1990* u dekoruan 1 550 kadro, nënoficerë, policë dhe ushtarë,

⁷² *Po aty*, F.489, V.1990, D.3, fl.2. “Mbi disa probleme që dalin nga takimet me prindërit e ushtarëve kufitarë”, 30.11.1990.

⁷³ *AQSH*, F.724, V.1990, D.15, fl.4. “Probleme dhe detyra që dalin për të përballuar disa shqetësime në kufi dhe ushtri”.

⁷⁴ *Po aty*, fl.5. “Probleme dhe detyra që dalin për të përballuar disa shqetësime në kufi dhe ushtri”.

⁷⁵ *Po aty*, F.489, V.1990, D.3, fl.2-3. “Mbi disa probleme që dalin nga takimet me prindërit e ushtarëve kufitarë”, 30.11.1990.

⁷⁶ *Po aty*, F. 489, V.1990, D.3, fl.4-5. Informacion i MPB-së: “Disa tentime masive për kalimin e kufirit në rrethet Shkodër, Sarandë e Gjirokastrë dhe shqetësimet edhe në efektivat e kufirit”, 30.12.1990.

⁷⁷ Posta kufitare Rrushkull (Shkodër) u dekorua nga regjimi i kohës me medalje të lartë dhe motivacionin: “Për arritje të larta në përgatitjen politiko-luftarake të efektivit, për forcimin e gjendjes moralo-politike e të disiplinës ushtarake, për lidhje e bashkëpunim të ngushtë me banorët e zonës e të brezit kufitar, si dhe organizimin me vigjilencë e gatishmëri të lartë të shërbimit në mbrojtjen e kufirit shtetëror të RPSSH”. (*AQSH*, F.489, V.1989, D.140, f.225. Dekrete për dekorime).

ndërsa 3 500 të tjerë u stimuluan në forma alternative,⁷⁸ kryesisht përmes shpërblimeve financiare ose trajtimeve.⁷⁹ Dekreti i fundit për vitin 1990 u nxor në javën e parë të janarit 1991,⁸⁰ në kushtet e ndryshimit të sistemit politik dhe vendosjes së pluralizmit. Në këtë periudhë u dekoruan 7 njësi, 135 oficerë, 35 nënoficerë, 11 ushtarë, 44 rezervistë dhe 50 punonjës civilë, në total 284 urdhra e medalje.⁸¹ Në të gjitha rastet, motivacioni i dhënies së dekoratave lidhej me

“përgatitjen politiko-luftarake dhe për vigjilencë e gatishmëri të lartë në mbrojtjen e kufirit shtetëror të RPSSH”, si edhe me “vigjilencën, gatishmërinë e trimërinë e treguar në kapjen ose eliminimin disa elementëve armiq”, duke kontribuar në mbrojtjen e kufirit shtetëror të RPSSH-së.

Roli i banorëve në zonat kufitare ishte thelbësor në jetësimin e objektivit politik të mbrojtjes së kufirit dhe parandalimit ose eliminimit të arratisjeve. Niveli i lartë i kontrollit dhe indoktrinimit shoqërohej gjithashtu me kultivimin e urrejtjes ndaj individëve që tentonin arratisjen, të cilët shpesh etiketoheshin si “armiq”. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vitit 1990, rezulton se, në të gjitha rastet e ndjekjes në kufi që përfunduan me vrasje, kanë marrë pjesë direkt ose indirekt edhe grupet vullnetare civile lokale. Rreth 200 dekorata dhe medalje të akorduara banorëve pranë pikave kufitare dëshmojnë njohjen dhe vlerësimin politik të këtij roli. Në vitin 1990, konteksti i përgjithshëm i zhvillimeve në vend ndikoi edhe në zonat kufitare, ku raportohej për rënie të vëmendjes, interesit dhe reagimit të banorëve lokalë ndaj personave që hynin pa leje

⁷⁸ *AQSH*, F.14/AP-OU, V.1990, D.12, fl.43. Procesverbal i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të Partisë, 01.06.1990.

⁷⁹ Për shembull, në rastin e vrasjes në kufi në Kapshticë të qytetarit B. Osmani më 30 maj 1990, në njoftimin e DPB-së thuhej: “*Ushtarit që e vrau iu dha leje 10 ditore si shpërblim.*” *AQSH*, F.489, V.1990, D. 3, fl. 1. Për asgjësimin e shkelësit të kufirit nga brenda – jashtë, Bujar Osmani, në pikën kufitare të Kapshticës, reparti nr. 425, Bilisht.

⁸⁰ *Fletorja Zyrtare*, nr.1, 05.01.1991 (Tiranë: 1991). Presidiumi i Kuvendit Popullor, Dekorime.

⁸¹ Në këtë listë bënin pjesë edhe ushtarët e oficerët që qëlluan mbi I. Zarin (shkurt 1990), E. Krajën dhe Dh. Sokolin (prill 1990), oficeri që qëlloi mbi V. Beqin (maj 1990) dhe ai që hapi zjarr mbi K. Xhajën (shkurt 1990). Në tetor të vitit 1990, disa ditë pas kthimit të Ramiz Alisë nga OKB-ja, u dekoruan gjithashtu edhe disa nga ushtarakët / kufitarët që realizuan vrasjen e P. Pashakos (prill 1990) dhe të riut P. Pëllumbi (qershor).⁸¹

në zonat kufitare.⁸² Një faktor tjetër ishte edhe problematika sociale. Raporte të ndryshme dëshmonin për mungesa afatgjata të disa ushqimeve bazë,⁸³ për jetë në kushte izolimi edhe nga zonat urbane,⁸⁴ si dhe për mungesën e shërbimeve elementare: në shumë fshatra nuk kishte berberë, këpucarë apo rrobaqepës; mungonin çerdhet, kopshtet dhe infermierët, dhe banorët detyroheshin të zbrisnin deri në qytet për të kryer edhe nevoja të thjeshta. Në tërësi, mungonte jeta kulturore dhe artistike. Qeveria iu përgjigj këtyre situatave dhe shqetësimeve duke ndërmarrë një varg masash mbështetëse emergjente për banorët e zonave kufitare.⁸⁵ Gjatë vitit 1990, këto masa u shtuan përmes zhvillimit të ekonomisë private familjare, rritjes së numrit të të drejtave të studimit, ofrimit më të madh të mbështetjes me produkte dhe pajisje, si dhe përmes politikave sociale për pensionet në fshat. Gjithashtu, në investimet mbështetëse përmenden 8 televizorë të rinj, 7 biblioteka, rreth 2 000 libra dhe materiale të tjera kulturore e sportive, 5 ujësjellës të rinj, 8 dyqane për ushtarët, si dhe 2 mensa e kuzhina për punëtorët e fortifikimit.⁸⁶

Vrasjet në kufi dhe drejtësia e munguar tranzicionale

Trajtimi i praktikave të vendeve ish-komuniste ndihmon për një vlerësim më të saktë të rastit shqiptar dhe për të sugjeruar sfida për të ardhmen. Në pothuajse të gjitha këto vende, personat e vrarë në kufi nuk kanë status zyrtar “*dëshmor*” apo emërtime të ngjashme, por përgjithësisht konsiderohen viktimat të regjimit, viktimat politike ose viktimat të represionit shtetëror. Në RFGJ, pas viteve ’90, personat e vrarë gjatë tentativave për të kaluar Murin e Berlinit ose kufirin perëndimor të Republikës Demokratike Gjermane (DDR) u shpallën zyrtarisht viktimat të diktaturës. Niveli më i lartë gjyqësor i shpalli antikushtetues urdhrat për vrasje, ndërsa familjet e viktimave përfituan rehabilitim, nderime

⁸² *AQSH*, F. 489, V.1990, D.3, fl.5. Mbi kapjen dhe asgjësimin e disa shkelësve, të cilët tentuan të kalonin kufirin në mënyrë të paligjshme në sektorin e repartit nr. 210, Librazhd, gjatë muajit maj 1990, 31.05.1990.

⁸³ *Po aty*, F.14/AP-OU, V.1987, D.24, fl.17. Mbi disa çështje që kishin të bënin me gjendjen moralo-politike në zonat kufitare.

⁸⁴ *Po aty*, fl.13. Mbi forcimin e gjendjes moralo-politike të zonës kufitare.

⁸⁵ *Po aty*, fl. 7. Mbi forcimin e gjendjes moralo-politike të zonës kufitare.

⁸⁶ *Po aty*, F.489, V.1990, D.7, fl.2. Informacion mbi disa shqetësime dhe masat që u morën për të parandaluar rastet e arratisjeve dhe thellimin e disiplinës në ushtri, 16.10.1990.

publike dhe kompensim financiar. Disa vende përkujtimore të rëndësishme mbajnë emrat e personave të vrarë, ndërsa një pjesë e këtyre emrave janë vendosur edhe në shkolla ose objekte të tjera publike. Në Hungari, Çeki, Sllovaki, Poloni etj., viktimat e kufirit u shpallën të pafajshme dhe u përfshinë në ligjet e rehabilitimit; vendimet gjyqësore anuluan dënimet për arratisje dhe u shoqëruan me vlerësime morale, financiare dhe njohje publike, përfshirë ngritjen e përmendoreve ose krijimin e muzeve të dedikuara. Në Bullgari dhe Rumani, proceset ishin më të pjesshme, duke përfshirë rehabilitime përmes proceseve individuale gjyqësore, si dhe akte nderuese kryesisht nga aktivistë civilë, më shumë sesa nga shteti, veçanërisht për të vrarët në kufijtë me Greqinë dhe Turqinë. Modeli rumun ngjan më shumë me modelin shqiptar, i karakterizuar nga mungesa e drejtësisë tranzicionale dhe ngarkesat politike, si dhe nga nismat kryesisht personale/familjare për të siguruar pafajësi përmes gjykatave. E njëjta qasje u reflektua edhe në proceset gjyqësore ndaj ushtarakëve dhe zyrtarëve përgjegjës për vrasjet në kufi. Në RFGJ/DDR u mbajtën rreth 120 procese gjyqësore kundër kufitarëve që vranë civilë gjatë tentativave për arratisje, ku midis të dënuarve ishin edhe ish-kreu i shtetit, Honecker, dhe ish-shefi i STAS-it, Erich Mielke. Në vende si Polonia dhe Hungaria, çështjet e vrasjeve në kufi dhe proceset rivlerësuese u mbyllën herët, 2-3 dekada para vitit 1989, thuhet si në modelin gjerman. Bullgaria, dhe veçanërisht Rumania, përafrohet me modelin shqiptar, ku hetimet ndaj ish-oficerëve dhe ushtarëve të akuzuar për vrasje nuk ishin shteruese dhe procesi nuk u zhvillua sipas standardeve të drejtësisë tranzicionale. Angazhimet parlamentare, si në Rumani (2000) ashtu edhe në Shqipëri (2006), përveç pjesës deklarative (rezoluta, deklarata), nuk shoqëroheshin me hetime të thella dhe nuk arritën të sillnin drejtësi për vrasjet në kufi gjatë viteve 1989-1990. Këto nisma kishin natyrë politike, elektorale, selektive dhe të përkohshme, dhe asnjëherë nuk u institucionalizuan, as nuk ishin objekt i institucioneve të së drejtës.

Kur ndodhën vrasjet në vitet '90, hetimet nuk u zhvilluan ndaj autorëve, por ndaj të vrarëve. Për shembull, sipas dosjeve hetimore, në rastin më të njohur në Shkodër, hetimet nisën vetëm kundër viktimave.⁸⁷

⁸⁷ *Po aty*, F.489, V.1990, D.6, fl. 1-2. Në relacionin e kryetarit të Hetuesisë së Përgjithshme, drejtor Kryeministrit A. Çarçani, faktohet se “komandanti ka qëlluar me armë duke i shkakuar vdekjen” 26-vjeçarit, ndërsa ushtarët kanë plagosur për vdekje Dhuratën.⁸⁷ Sipas relacionit të komandantit Enver L. dhe komisarit Përparim

Të dy viktimat ishin të paarmatosur, nuk paraqisnin rrezik për kufitarët, nuk kishin rekorde penale të mëparshme dhe arratisja e tyre ishte akt personal në kërkim të lirisë. Më 1993, procesi u rihap; ushtarakët përgjegjës pranuan fajin, por personi kryesor që qëllloi, komandanti i postës, që nga viti 1997 vazhdon të jetë në kërkim ndërkombëtar. Më 1995 nisi një proces tjetër për vrasjen e 16 qershorit 1990 në Shkodër, ku u dënua ushtari që kishte qëlluar, duke pranuar se kishte hapur zjarr pa paralajmërim. Nuk u zhvilluan hetime të thelluara dhe nuk u trajtuan përgjegjësitë për dhënien e urdhrit për vrasje, përfshirë edhe rastet e dhunimit publik të trupave të të vuarëve. E njëjta gjë vlen edhe për gjyqet ndaj nomenklaturës së lartë të PPSH-së dhe Sigurimit, të zhvilluara në mesin e viteve '90, ku vrasjet në kufi nuk ishin pjesë e hetimeve të thelluara.⁸⁸ Për më tepër, të gjithë zyrtarët u amnistuan ose u shpallën të pafajshëm pas vitit 1997, me argumentin se “*nuk mund të dënoheshin për veprime, të cilat nuk ishin të jashtëligjshme në kohën kur janë kryer*”^{*} dhe se aktet ishin kolektive. Ky motivacion, megjithatë, nuk qëndron.

Së pari, sepse përgjegjësia ishte personale për ata që qëlluan ose urdhëruan vrasjet apo dhunimin e viktimave, ndaj çdo individ duhej të mbante përgjegjësi për veprimet e veta.⁸⁹ Nëse teza e studiuesit Gabriel M. J., sipas së cilës është e vështirë të gjendet një emërues i përbashkët për vrasjet në kufi – për të vlerësuar ligjërisht nëse veprimet e rojeve të kufirit duhen trajtuar si krime lufte, krime të regjimit apo si ndëshkime të

T., konfirmohet gjithashtu se “komanda e batalionit e ndoqi situatën duke dhënë urdhra e udhëzime të shpejta që ndihmuan komandantin e postës kufitare Rushkull për marrjen e vendimeve të drejta”.

⁸⁸ Qemal Lame, “Ngjarja e 1987-ës që tronditi diktaturën, ish-kryehetuesi: Si u arratisën dy familje nga Vermoshi! Porosia e Ramizit!”, Gazeta *Panorama*, 11.08.2023, cituar nga <https://muzeuimemories.info/ish-kreu-i-hetuesise-viti-1990-eshte-me-i-pergjakshmi-ne-historine-e-arratisjeve-nga-kufiri/> (shikuar më 18.12.2025).

^{*} Midis të akuzuarve ishin katër drejtuesit kryesorë të MPB-së dhe Sigurimit, Hekuran Isai, Simon Stefani, Zyliftar Ramizi dhe Agron Tafa, ish-kryetari i Gjykatës së Lartë – Aranit Çela, ish-prokurori i Përgjithshëm – Rrapi Mino, ish-drejtuesi i MPB-së Sarandë – Veiz Hadëri, ish-drejtuesit e policisë – Dilaver Bengasi, Shkëlzen Bajraktari e Zef Loka, disa ish-sekretarë të parë të Komiteteve të Partisë dhe tre anëtarë të Byrosë Politike. Pesë prej tyre, përfshirë drejtuesin e postës, u gjykuan në mungesë, pasi kishin emigruar pas viteve 1991-1993.

⁸⁹ Hannah Arendt, *Responsibility and Judgment*, Edited by Ronald Beiner (New York: Schocken Books, 2003), 71.

justifikueshme nga rrethanat e kohës⁹⁰ – vlen për RFGJ/DDR ose për Shqipërinë para vitit 1990, rastet e vrasjeve në kufi gjatë vitit 1990 në Shqipëri tregojnë të kundërtën: ligji i atëhershëm i ndalonte dhe ato ishin në kundërshtim me të. Nga ana tjetër, me të drejtë, studiuesja Adams, duke u bazuar në analizën e rasteve të vrasjeve në kufi në Gjermaninë Lindore, vlerëson se drejtësia tranzicionale dhe përballja me të kaluarën e dhunshme duhet të bazohet jo vetëm në interpretimin ligjor të kohës, por edhe në përputhje me parimet universale të të drejtave të njeriut, të cilat kanë evoluar pas rënies së regjimit.⁹¹ Justifikimet ligjore janë të pamjaftueshme për të pranuar pafajësinë e zyrtarëve që urdhëruan dhe kryen vrasjet. Në rastin shqiptar, kjo tezë ende nuk është pranuar.

Së dyti, sepse pas majit 1990 të gjitha vrasjet ishin akte pa mbështetje ligjore, në kundërshtim me legjislationin e ri penal. Pra, personat përgjegjës nuk mund të akuzoheshin për veprime që ishin të jashtëligjshme në kohën kur u kryen. Si përfundim, sipas pesë kriterëve të drejtësisë tranzicionale – njohja zyrtare si viktimat të shtetit totalitar, deklarimi i pafajësisë nga gjykatat, kthimi i nderit dhe i statusit moral, dëmshpërblimi financiar për familjet, si dhe vendosja e përmendoreve, emërtimi i rrugëve, krijimi i muzeve etj., – asnjë prej tyre nuk është përmbushur plotësisht në rastin e vrasjeve në kufi në Shqipëri. Tri kriteret janë përmbushur vetëm pjesërisht (pafajësia, nderimi moral dhe përfshirja muzeale), ndërsa dy të tjera ende nuk janë trajtuar (njohja zyrtare si viktimat të shtetit totalitar dhe dëmshpërblimi financiar për familjet).

Referuar tezës së Arendt-it dhe studiuesve të tjerë që trajtojnë praktikën e vrasjeve gjatë Luftës së Dytë Botërore, mund të vlerësohet se me vrasjet në kufi e keqja u institucionalizua brenda sistemit, duke u dhënë kështu vrasjeve kufitare mbështetje ideologjike dhe, në mënyrë indirekte, legjitimitet shtetëror. Ekzekutuesit – kryesisht ushtarët dhe oficerët e kufirit, të rinj 20-21 vjeç, të indoktrinuar dhe të përzgjedhur për atë shërbim – ishin krijim dhe produkt i ingranazhit të sistemit. Ata ishin të gatshëm të përdroreshin për gjithçka që sistemi kishte nevojë, me parimin se çdo individ ishte i zëvendësueshëm pa prekur sistemin dhe se të gjithë do të vepronin njësoj, pra do të qëllonin mbi viktimat për të

⁹⁰ Malfred J. Gabriel, “Coming to Terms with the East German Border Guards Cases”, *SSRN* (2000), f.21.

⁹¹ Kif Augustine Adams, “What is Just?: The Rule of Law and Natural Law in the Trials of Former East German Border Guards”, *Stanford Journal of International Law*, 29 (1993): 271-291.

zbatuar urdhrin. Zyrtarët që zbatonin urdhrat, si në rastet e analizuara nga Arendt-i, ashtu edhe ata që qëllonin në kufi në rastin shqiptar, shpesh justifikoheshin duke thënë se “*vetëm po zbatonin procedurat/urdhrat*”. Ata e konsideronin ekzekutimin si rutinë, pjesë të punës dhe detyrë, pa lidhje me aspektin moral, ndërgjegjen ose reflektimin personal. Teza e “banalitetit të së keqes” për ushtarët dhe e konformizmit mekanik për zyrtarët e përfshirë mund të merret në konsideratë, sidomos për disa aspekte psikologjike dhe administrative të vrasjeve në kufi.

Nga ana tjetër, zyrtarët përgjegjës dhe kufitarët që qëlluan e dinin se, në rast sukcesi, do të përfitonin shpërblime dhe privilegje, ndërsa viktimat, të konsideruar *apriori* si armiq, nuk do të kishin mbështetje shtetërore dhe publike. Cilat do të ishin pasojat nëse do të refuzonin urdhrin? Sipas të dhënave të dokumentuara mbi vrasjet në kufi, në asnjë rast kufitarët nuk treguan tolerim, nuk refuzuan urdhrat dhe nuk tentuan të gjenin zgjidhje që do të shmangte pasoja për jetën. Ata vepruan me vendosmëri, duke ndaluar ose eliminuar çdo individ sipas urdhrin, dhe jo vetëm që vepruan me ndërgjegje, por shpesh tentuan të përfitonin nga veprimet e tyre në favor të pozitës së tyre personale dhe profesionale, statusit social dhe, sidomos, impaktit në të ardhmen për statusin politik. Kjo tezë mbështetet nga fakti se pas ndryshimit të sistemit politik në Shqipëri, asnjë prej tyre nuk doli vullnetar për të denoncuar vrasjet në kufi, për të rrëfyer apo për të treguar vendndodhjen e varreve ende të pagjetura, dhe nuk kërkuan ndjesë publike, as nuk hoqën dorë nga titujt dhe dekoratat e përfituara për meritë të vrasjeve.

Midis arsyeve të ndryshme të mungesës së progresit në hetime mbi vrasjet, përfshihet edhe procesi i emigrimit masiv dhe periodik që shoqëroi hapjen e vendit duke nisur nga viti 1991, ndryshimet e plota në administratën dhe strukturën shtetërore, mungesa e interesit dhe presionit politik sistematik, si dhe fakti se ekzistojnë të dhëna për persona të zhdukur, të cilët ende nuk janë identifikuar, por mund të jenë vrarë ose plagosur rëndë gjatë arratisjes. Hetimet shtetërore kërkojnë gjithashtu shtrirjen e tyre në shtetet kufitare, praktikë që ende nuk është aplikuar. Në tërësi, nga 175 raste të përpjekjeve për të gjetur personat e zhdukur,

përfshirë edhe rastet e vrasjeve në kufi, shumica e tyre ishin investim familjar, joshtetëror.⁹²

Përfundime

Vrasjet në kufi gjatë vitit 1990 përbëjnë një nga episodet më të errëta të trashëgimisë së sistemit totalitar në Shqipëri dhe një dëshmi të vazhdimësisë së mekanizmave represivë deri në fundin e regjimit. Ato zbulojnë hendekun e thellë midis normës ligjore dhe praktikës shtetërore, ku ligji u nënshtrohej direktivave politike dhe ideologjisë së dhunës. Në një kohë kur PPSH-ja dhe Ramiz Alia shpallnin masa demokratizuese, kufiri shqiptar vijonte të përfaqësonte simbolin e frikës, izolimit dhe kontrollit total të shtetit mbi qytetarin. Në këtë kuptim, vrasjet në kufi nuk ishin akte të izoluar, por pjesë e një politike shtetërore, e mbështetur nga struktura politike, ushtarake dhe civile, që shërbente për të ruajtur rendin e brishtë të sistemit.

Në aspektin juridik, këto vrasje ishin të ndaluara nga Kushtetuta dhe Kodi Penal i kohës, të cilët nuk parashikonin dënim me vdekje pa gjyq dhe as përdorimin e forcës vdekjeprurëse ndaj shtetasve të paarmatosur që tentonin kalimin e kufirit. Pasi arratisja ishte dekriminalizuar në vitin 1990, përdorimi i armës ndaj qytetarëve përbënte shkelje të drejtpërdrejtë të ligjit, të normave humanitare dhe të vetë parimeve mbi të cilat regjimi pretendonte se po ndërtonte “reforma demokratizuese”. Pikërisht këtu qëndron domethënia e tyre: këto vrasje rrëzojnë mitin e “demokratizimit nga lart” dhe nxjerrin në pah kontrastin mes retorikës zyrtare dhe praktikës së dhunës shtetërore. Shoqëria shqiptare reagoi me heshtje — një heshtje e ushqyer nga frika, indoktrinimi dhe mungesa e besimit institucional — çka bëri që kujtesa e këtyre ngjarjeve të mbetet e zbehur, pa memorializim dhe pa drejtësi. Kjo nënvlerësim i kujtesës historike dobësoi kapacitetin e shoqërisë për reflektim moral dhe për ndërtimin e një kulture demokratike të përgjegjësive.

Në krahasim me praktikën e vendeve të tjera ish-komuniste, modeli shqiptar dallon për brutalitetin, vonesën dhe mungesën e çdo forme

⁹² Kujto (2023). “Kërkimet për viktimat e zhdukura të komunizmit, peng i përplasjes mes institucioneve”, në: <https://kujto.al/kerkimet-per-viktimat-e-zhdukura-te-komunizmit-peng-i-perplasjes-mes-institucioneve/> (shikuar më 18.12.2025).

drejtësie tranzitore. Shqipëria nuk arriti të ndiqte shembujt e Gjermanisë Lindore, Hungarisë apo Çekoslovakisë, ku u zhvilluan hetime dhe procese gjyqësore për krimet në kufi, as të ndërtonte një mekanizëm të qëndrueshëm të përballjes me të kaluarën. Rezoluta e vonuar e Kuvendit të Shqipërisë, e miratuar më shumë se dy dekada pas ngjarjeve, mbeti një akt deklarativ, pa efekt juridik apo moral. Mungesa e nderimit publik dhe e rehabilitimit të viktimave dëshmon se shoqëria shqiptare ende nuk e ka tejkalar fazën e mohimit dhe heshtjes dhe nuk ka ndërtuar një kulturë të qëndrueshme të kujtesës.

Në përfundim, raste të tilla mikrohistorike si vrasjet në kufi gjatë vitit 1990, janë thelbësore për të kuptuar më mirë natyrën e asaj periudhe, kontradiktat midis ligjit dhe praktikës, si dhe mekanizmat e frikës dhe dhunës që karakterizuan fundin e sistemit totalitar. Analiza e tyre ndihmon në rindërtimin e një narrative të drejtë mbi vitin 1990 – si vit i përplasjes ndërmjet ideologjisë dhe aspiratës për liri – dhe ofron një bazë për reflektim institucional dhe shoqëror mbi nevojën për drejtësi, kujtesë dhe përgjegjësi historike. Përballja me këtë të kaluar mbetet një detyrë e hapur për shoqërinë dhe shtetin shqiptar në procesin e konsolidimit demokratik dhe të integritit evropian.

Burime e bibliografi:

Arkiva:

Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (AQSH)

Arkivi i Ministrisë së Punëve të Brendshme (AMPB)

Arkivi i Ministrisë për Europën e Punët e Jashtme (AMEPJ)

Dokumente të botuara:

Fletorja Zyrtare, Tiranë: 1988-1991

Literaturë:

ADAMS, Kif Augustine. “What is Just?: The Rule of Law and Natural Law in the Trials of Former East German Border Guards”. *Stanford Journal of International Law*, 29 (1993): 271–291.

ALIA, Ramiz. *Jeta ime*. Tiranë: Toena, 2010.

- ARENDR, Hannah. *Responsibility and Judgment*. Edited by Ronald Beiner. New York: Schocken Books, 2003.
- BIBERAJ, Elez. *Shqipëria në tranzicion: Rruga e vështirë drejt demokracisë 1990-2010*. Tiranë: AIIS, 2011.
- BLOCH, Marc. *The historian's craft*. New York: Alfred A. Knopf, 1953.
- DERVISHI, Kastriot. *Vrasjet në kufi në vitin 1990*. Tiranë: ISKK, 2015.
- GABRIEL, Manfred. "Coming to Terms with the East German Border Guards Cases". *SSRN* (2000).
- GODOLE, Jonila. "Albania: Coming to Terms with the Communist Dictatorship". In *After Dictatorship: Instruments of Transitional Justice in Post-Authoritarian Systems*. Ed. Peter Hoeres and Hubertus Knabe, De Gruyter. Berlin/Boston: 2023.
- GURAZIU, Filip. *Mollat e Vjetit të Ri. Dromca kujtimesh*. Tiranë: ISSK, 2021.
- HERTLE, Hans-Hermann & Maria Nooke. Special CWIHP Research Report: "The Victims at the Berlin Wall, 1961-1989", *Wilson Center* (2001).
- HOXHA, Çelo & Jonila Godole & Kastriot Dervishi. *Gjyqet ndaj nomenklaturës komuniste 1993-1996*. IDMC. Tiranë: Filara, 2023.
- HUMAN RIGHTS WATCH (HRW), Human Rights in Post-Communist Albania, 1606, 1 March 1996.
- KADARE, Ismail. *Nga njëri dhjetor në tjetrin*. Paris: Fayard, 1991.
- KIERZKOWSKI, H. Okólski, M., & Wellisz, S.H. (Eds.). *Stabilization and Structural Adjustment in Poland* (1st ed.). Routledge: 1993.
- KRASNIQI, Afrim & Vëra Stojarová. "State and society in the Communist Albania 1945-1990", ISP. Tiranë: EMAIL, 2020.
- KRASNIQI, Afrim (ed.). *VOA dhe Shqipëria: Viti 1990 në "Zërin e Amerikës"*. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, 2025.
- KRASNIQI, Afrim. "Trajtimi i të kaluarës në raport krahasues: Shqipëria dhe Evropa Lindore". Në *Të mohuar nga regjimi*. Tiranë: AIDSSH, 2020.
- KRASNIQI, Afrim. *Kriza e ambasadave. Shqipëria në vitin 1990*, ASA/Instituti i Historisë. Tiranë: Botimet albanologjike, 2021.
- KRASNIQI, Afrim. "Sistemi qeverisës dhe aspekte të përfaqësimit politik në Shqipëri (1945 -1990)". Në (ed.) Afrim Krasniqi, Vëra Stojarová. *State and society in the Communist Albania 1945-1990 / Shteti dhe shoqëria në Shqipërinë komuniste (1945 -1990)*, ISP. Tiranë: EMAL, 2020.

- LAÇO, Teodor. *Kohë për të kujtuar, kohë për të harruar*. Tiranë: Toena, 1998.
- LAME, Qemal. *Kur shembeshin themelet*. Tiranë: Onufri, 2014.
- STANCU, Constantin-Raducu. *The Political Use of Capital Punishment in Communist Romania*. Vienna: Central European University, 2012.
- TIU, Ilarion & Duduciuc, Alina. “Escape from communism. Last romanians’ migration qavesduring ’80’s.” *Osterreichish Rumanischer Akademischer Verein. SSRN* (2015).
- “The Last Domino”, *NYT*, 26.01.1990, Section A.
- WOODCOCK, Shannon. *Life is war: Surviving Dictatorship in Communist Albania* (Bristol: Hammer On Press, 2016).

Revista:

Studime historike, Tiranë: Instituti i Historisë, viti 2019-2024.

PROF. DR. AFRIM KRASNIQI

Institute of History / Academy of Sciences of Albania
 afrimkrasniqi@gmail.com

S u m m a r y

**BORDER KILLINGS IN ALBANIA, 1990:
 BETWEEN LAW, IDEOLOGY, AND STATE VIOLENCE**

This study examines the phenomenon of border killings in Albania during the period May–December 1990 as one of the most documented forms of state violence at the end of the totalitarian regime. Although quantitatively limited compared to the broader spectrum of state crimes committed between 1945 and 1990, these events offer clear evidence of the persistence of repressive mechanisms on the eve of the regime’s collapse. Adopting a microhistorical approach, the research explores the contradictions between law and practice, arguing that the border killings—carried out in breach of constitutional and criminal norms—reveal the dominance of ideological motives over legal ones. This case study challenges the regime’s official rhetoric of democratization and exposes the structural continuity of political repression.

From a legal perspective, the border killings were prohibited by the Albanian Constitution and Penal Code, which did not authorize the use of

lethal force or executions without trial. Despite the formal decriminalization of escape in 1990, unarmed citizens were targeted and killed, demonstrating the complete subordination of law to political ideology. These acts stand in stark contrast to the official discourse on “reform” and “liberalization,” revealing the regime’s unwillingness to abandon coercion as an instrument of control. Their meaning lies not only in their brutality but in their capacity to uncover the hypocrisy of late communist legality and to dismantle the myth of a controlled democratization.

Albanian society’s silence in the face of these crimes—rooted in decades of fear, indoctrination, and moral exhaustion—further deepened the fracture between memory and justice. The lack of public reaction, institutional acknowledgment, and memorialization led to the erosion of collective memory and hindered the moral reconstruction of post-communist society. Compared with other former communist countries, Albania stands out for its absence of transitional justice. Unlike East Germany, Hungary, or Czechoslovakia, where legal and moral rehabilitation followed, Albania failed to investigate or prosecute those responsible. The late parliamentary resolution condemning communist crimes remained a declarative act without binding effect, reflecting a persistent reluctance to confront the past.

Microhistorical cases such as the 1990 border killings are essential to understanding the contradictions of that year—between reformist rhetoric and the persistence of state terror—and to grasping how fear and ideology shaped the transition from dictatorship to democracy. They provide a crucial framework for reflecting on justice, historical responsibility, and the meaning of freedom. The failure to reckon with such crimes continues to weigh on Albania’s collective conscience and remains a test of the country’s moral and institutional maturity as it seeks to consolidate democracy and align with European standards.

Keywords: Albania, 1990, border killings, state violence, ideology, law, microhistory, transitional justice, collective memory, democratization.

